

URDHËR
Nr. 204, datë 21.3.2024

**PËR DISA NDRYSHIME NË URDHRIN NR. 21, DATË 19.1.2023,
PËR NJË PLAN MENAXHIMI SHUMËVJEÇAR PËR PESHKIMIN FUNDOR TË
QËNDRUESHËM NË DETIN ADRIATIK (NËNZONAT GJEORAFIKE 17 DHE 18)**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës; të shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 1, të nenit 3, të marrëveshjes “Për krijimin e Komisionit të Përgjithshëm të Peshkimit për Mesdheun”, të ratifikuar me ligjin nr. 9093, datë 3.7.2003,

URDHËROJ:

Në urdhrin e ministrit nr. 21, datë 19.1.2023, “Për një plan menaxhimi shumëvjeçar për peshkimin fundor të qëndrueshëm në detin Adriatik (nënzonat gjeografike 17 dhe 18)”, bëhen ndryshimet si vijon:

1. Pika 3 riformulohet si më poshtë:

“3. Të gjitha anijet e peshkimit fundor, që peshkojnë peshq fundorë, nuk kalojnë 21420 ditë peshkimi në vitin 2024, të ndara sipas segmentit të flotës, në përputhje me pikën 4 të këtij urdhri.”.

2. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Ditët e peshkimit ndahen sipas segmenteve të flotës për anijet e peshkimit fundor që përdorin rrjetë fundore me timon (OTB), si më poshtë:

a) segmenti ≥ 12 m dhe < 24 m: 15 789 ditë;

b) segmenti ≥ 24 m: 5 631 ditë.”.

3. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Politikave dhe Programeve të Peshkimit dhe Akuakulturës në Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj